

Neni 10

Kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit (ndryshuar pika 1, shtuar pika 3, 4, 5 dhe 6 me ligjin nr.78, datë 21.9.2023)

1. Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Menjëherë pas caktimit ose ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, titullari i autoritetit publik i njofton Komisionerit emrin dhe kontaktet e nëpunësit.

2. Koordinatori për të drejtën e informimit ushtron kompetencat e mëposhtme: a) i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij; b) krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji; c) bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj; ç) regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre; d) dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar; dh) verifikon rastet për dhënien e falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13, të këtij ligji; e) kryen njoftimet paraprake, sipas neneve 14 dhe 15, të këtij ligji, si dhe komunikon me kërkuar, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

3. Gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit të caktuar si koordinator për të drejtën e informimit për shkelje të dispozitave të këtij ligji, autoriteti publik kërkon mendimin e Komisionerit për çështjen. Në vendimin përfundimtar autoriteti publik arsyeton edhe për pranimin ose refuzimin e mendimit të Komisionerit.

4. Nëpunësi i caktuar sipas pikës 1 të këtij neni, përveç pagës mujore të pozicionit në të cilin është emëruar, përfiton edhe një shtesë për natyrë të veçantë pune për punën e tij si koordinator për të drejtën e informimit. Shtesa për natyrë të veçantë pune përfitohet vetëm gjatë kohës që nëpunësi kryen edhe detyrat shtesë si koordinator për të drejtën e informimit.

5. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim masën e shtesës për natyrë të veçantë pune dhe kriteret për përcaktimin e saj për koordinatorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të të cilëve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Shtesa sipas pikës 4 të këtij neni për koordinatorët e autoriteteve publike, struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve të të cilëve nuk përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, përcaktohet nga organi që sipas legjislacionit në fuqi përcakton strukturën dhe nivelin e pagave për nëpunësit e atyre autoriteteve.